



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.375/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada - Gllogjani dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur përkitazi me ankesën subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë - dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterit në mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 14.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa A.nr.375/2021 e datës 12.02.2021, e ushtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë - dega në Fushë Kosovë, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,600.00 (njëmijë e gjashtëqind) euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit për fushatën zgjedhore mbi rrugë publike.

II. DETYROHET subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Lëvizja Vetëvendosje dega në Fushë Kosovë, ka parashtruar ankesë A.nr.375/2021 me datë 12.02.2021, me të cilën pretendon se në rrugën publike përkatësisht në Fushë Kosovë, kanë vërejtur material zgjedhor në rrugën e Pejës në Fushë Kosovë, të vendosur mbi urë, në kundërshtimin e nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë lidhur me ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Fushë Kosovë, duke kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 13.02.2021 në ora 10:00.

Në përgjigje në ankesë të datës 13.02.2021, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i ka kundërshtuar pretendimet e ankuesit duke theksuar se në rastin konkret nga fotografia e paraqitur si prove nuk mund të vërtetohet se materiali reklamues zgjedhor-posterat a janë të subjektit politik AAK, apo të ndonjë subjekti tjetër politik, sepse nga fotografia nuk mund të identifikohet qartë se këta postera cilit subjekt politik i takojnë dhe nga kush janë vendosur këta postera. Po ashtu parashtruesi i ankesës nuk ka specifikuar datën dhe

kohen se kur ka ndodhur shkelja e supozuar qe kërkohe sipas dispozitës se nenit 3.4 te rregullave dhe proceduarve te PZAP. Po ashtu nga fotografia e dorëzuar si prove absolutisht nuk mund te identifikohet edhe vendi se ku oshte vendosur ky poster qe me tepër nuk munde te identifikohet cilit subjekt politik i përket ky poster. Mire po edhe sikur te ishte ky poster i AAK i njëjtit konsiderojmë se duket qe është vendosur ne nje vend i i cili edhe me herët ka shërbyer si hapësira reklamues për vendosjen e posterave reklamues. Në rastin konkret ankuesi nuk e din kohën kur është vendosur posteri në atë vend edhe pse është me rëndësi të theksohet se koha kur ka ndodhur shkelja e supozuar ka shumë rëndësi për shqyrtimin dhe llogaritjen e afatshmërisë së ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar.

Në fund parashtruesi i përgjigjes në ankesë i ka propozuar PZAP-së që ankesën ta hedhë poshtë si të pasafatshme ose ta refuzojë si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga foto e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se materialet zgjedhore - posteri i kandidatëve për deputet nga subjektit politik AAK, është vendosur në hapësirat publike-rrugë, përkatësisht në mbikalim, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se posterat e paraqitur me ankesë nuk shihen fare emrat dhe vendi se ku gjenden, paneli e refuzon si të pa bazuara sepse nga foto e bashkangjitur në ankesë shihet çartë se posterat janë të deputetëve të subjektit politik AAK, saktësisht të deputetit Daut Haradinaj dhe Ramush Haradinaj, andaj vendosja e materialeve zgjedhore-posterave në hapësirat publike-rrugë, përkatësisht mbikalim janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5, paragrafi 1, pika d) e Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuar politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Në raport me pretendimet e subjektit politik AAK-së, se ankesa e palës ankuese është e pas afatshme dhe si e tillë duhet të hedhet poshtë, paneli këto pretendime i refuzoi si të pa bazuara sepse pala ankuese ka paraqitur ankesë ditën kur ka hasur në posterat e vendosur ashtu siç parashihet në ankesë dhe si e tillë është pranuar si e rregullt. Shkaku që posterat kanë qenë të vendosur ditën kur është raportuar me ankesë vërtetohet se shkelja është ende aktive nga subjekti politik AAK, prandaj paneli vendosi që ta pranoj ankesën e subjektit politik LVV, duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik AAK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Paneli po ashtu me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës ka marrë parasysh edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 375/2021 më datën 14.02.2021

Kryesuesi i Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118.1 të LZP-së, par. 4 të